REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 139/17
Datë/Datum 14.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. Nr. 139/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej: z. Tefik Sylejmani - Kryetar, Goran Milenkoviq -referues dhe z.Blerim Dina–anëtar,duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE"Geo Map&Consult enginering"Shpk nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit:"Rindërtimi i informacioneve kadastrale në 15 zona kadastrale,komunat,Drenas,Skenderaj,Kamenicë dhe Viti" me nr. të prokurimit:60100/17/005/211 të iniciuar nga autoriteti kontraktues Agjencia Kadastrale e Kosovës, më: 07.06.2017, mori këtë :

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE ankues"Geo Map&Consult enginering"Shpk nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit:"Rindërtimi i informacioneve kadastrale në 15 zona kadastrale,komunat,Drenas,Skenderaj,Kamenicë dhe Viti" me nr. të prokurimit:60100/17/005/211.

II.Anulohet vendimi i autoritetit kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit:"Rindërtimi i informacioneve kadastrale në 15 zona kadastrale,komunat,Drenas,Skenderaj,Kamenicë dhe Viti" të iniciuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës me nr. të prokurimit:60100/17/005/211 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

III.Mos respektimi i këtij vendimi detyron panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-ës të ndërmarr masa ndaj autoritetit kontraktues,që nuk respekton vendimin e panelit shqyrtues të paraparë me këtë ligj

IV. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues Geo Map&Consult enginering"Shpk nga Prishtina janë pjesërisht të qëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së, ju kthehet sigurimi i ankesës.OE në afat prej 60 ditësh janë të obliguar të parashtrojnë kërkesë për tërheqjen e mjeteve në të kundërtën këto mjete barten në buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues Agjencia Kadastrale e Kosovës ka bërë njoftimin për kontratë me emrin "Rindërtimi i informacioneve kadastrale në 15 zona kadastrale komunat Drenas,Skenderaj,Kamenicë dhe Viti me nr.prokurimi 60100/17/005/211 me datë 27.03.2017 në faqe të KRPP-së, procedurë e hapur, kontratë për shërbime, me vlerë të madhe.

Kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, afati për ofertim ka qenë 12.04.2017 dhe të njëjtën ditë është bërë hapja e ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit te prokurimit ka qenë 24.04.2017.

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë 3 OE.

Komisioni vlerësues ka bërë vlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave dhe për kontratë ka rekomanduar anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit njoftimin për anulim e ka bërë me dt.24.04.2017.

Kundër këtij njoftimi në OSHP ka parashtruar ankesë OE: "Geo Map&Consult enginering"Shpk nga Prishtina, i cili pretendon se AK ka shkel nenin 1,56,59,62 dhe 72 të LPP-së.

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar.

OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues z.Bibajn i cli ka dhënë mendimin e vet në raportin e tij të ekspertizës i cili ka rekomanduar që ankesa të aprovohet si pjesërisht bazuar dhe të anulohet vendimi i AK për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit.

OE ankues është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues duke e njoftuar panelin shqyrtues me parashtresë me shkrim me dt.05.05.2017.

Ndërsa AK nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues ku përmes parashtresës me shkrim e njofton panelin shqyrtues dhe atë me dt.05.06.2017.

Paneli shqyrtues në pajtim me nenin 26 të Rregullores së punës së OSHP vendosi që seanca të mbahet pa prezencën e palëve ku paneli shqyrtoi shkresat e lëndës dhe atë: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues si dhe deklaratën e ekspertit shqyrtues i cili deklaroi para panelit:" se kam rekomanduar që lënda të kthehet në ri-vlerësim konform nenit 72 të LPP-ës në mënyrë që të sqarohet stafi profesional në raport me dëshmitë e ofruara sipas arsyetimit të eliminimit të OE ankues.

Paneli shqyrtues nga shkresat e lëndës,raporti i ekspertizës së ekspertit shqyrtues dhe nga deklarimi i tij gjeti se OE ankues është eliminuar me arsyetimin se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesat e DT lidhur me pikën 9.1 dhe 9.2 të DT se sipas CV nuk e mbulojnë dëshminë dokumentare mbi përvojë e punës,për këtë paneli shqyrtues i rekomandon AK që me rastin e ri-vlerësimit të veproj konform nenit 72 për vërtetimin e përvojës së punës për stafin e OE ankues me dëshmi të ofruara në pajtim me pikën 39.8 të rregullave të UOPP.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore se AK me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,56,59,62 dhe 72 të LPP-ës qëndrojnë sepse AK ka mund të sqaroj dyshimet lidhur me ofertën e OE ankues gjatë vlerësimit dhekërkesës për ri-shqyrtim duke vepruar në pajtim me nenin 72 të LPP-ës dhe pikës 39.8 të rregullave të

UOPP sepse kemi të bëjmë me OE i cila ka pas çmimin më tët ulët nga ofertuesit tjerë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe atë: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues gjeti se AK nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 72 të LPP-ës dhe pikës 39.8 të rregullave të UOPP.

Andaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Tefik Sylejmani